

Vendim nr. 272, datë 24.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 24.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (T) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TOM DEDAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-594, datë 08.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 31, 32, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, 59, pika 1, shkronja “b”, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Tom Dedaj në datën 04.06.2024 ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) kundrejt shtetasit A.B., kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe punonjësve të tjerë (të papërcaktuar), me pretendimin se janë konsumuar elemente të veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal (KP).

2. Kërkuesi në kallëzimin e tij ka pretenduar se nëpërmjet medias ka marrë dijeni se në datën 21.05.2024 Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) ka vendosur largimin nga sistemi i drejtësisë të shtetasit A.B., ish-anëtar dhe së fundmi kryetar i KLP-së, duke i hequr të drejtën për të qenë pjesë e këtij sistemi për një periudhë 15-vjeçare, si dhe me vendimin e datës 29.05.2024 KLP-ja ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Kërkuesi ka pretenduar se nga media ka mësuar se shtetasi A.B. në kandidimin e tij për anëtar të KLP-së ka paraqitur fakte të rreme për t’i shpëtuar vettingut, sikurse u konstatua, sipas tij, vetëm nga KPA-ja e mbledhur për të shqyrtuar këtë rast, pas ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK). Në të tilla rrethana, kallëzuesi ka kërkuar fillimin e procedimit penal për shtetasin A.B. si dhe të personave të tjerë, të cilët, sipas tij, janë përfshirë në këtë shkelje të rëndë, duke kërkuar kryerjen e veprimeve të duhura hetimore.

3. Me vendimin e datës 19.06.2024, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 290, pika “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për mosplotësim të elementeve të domosdoshme të konfigurimit të veprës penale të pretenduar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke pretenduar se vendimi është i padrejtë, pasi: (i) ekzistojnë fakte dhe prova që tregojnë për kryerje e veprave penale për të cilat ai ka bërë kallëzim; (ii) prokurorja është në konflikt të hapur interesi, për shkak se ka pasur më parë një çështje të tij, nga e cila ka dhënë dorëheqje, çështje e cila më pas përfundoi me pafajësi. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu kryerjen nga të kallëzuarit të veprës penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuar nga neni 257/a i KP-së.

4. Me vendimin nr. 412, datë 02.08.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë) ka vendosur rrëzimin e

ankimit nr. 412, datë 02.08.2024 kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë së Posaçme, me arsyetimin se ndjekja penale nuk mund të fillojë, pasi pretendimet e kallëzuesit nuk përmbajnë elemente të veprave penale të kallëzuara ose të ndonjë vepre tjetër penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi kallëzues, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Posaçme për hetime të mëtejshme. Kërkuesi ka ngritur, ndër të tjera, pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë, pasi prokurorja dhe gjyqtarja e shkallës së parë ishin në konflikt interesi, për shkak se e kanë hetuar e dërguar kërkuesin në gjyq, padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin, për veprën penale “Korrupsioni pasiv”, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së.

5. Me vendimin nr. 233 (87-2024-339), datë 21.11.2024, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me arsyetimin se të dhënat e pasqyruara në kallëzim janë të pamjaftueshme për të krijuar dyshimin se shtetasi A.B. ka falsifikuar/përdorur akte të falsifikuara ose ka kryer veprime që përbëjnë mospërmbyshje të rregullt të detyrës gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar të drejtë konkludimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë se në kallëzimin e paraqitur nga kallëzuesi nuk është përmendur asnjë e dhënë lidhur me veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuar nga neni 257/a i KP-së. Ndërkohë, për pretendimin e kërkuesit lidhur me pjesëmarrjen në gjykim në shkallë të parë të gjyqtarës, e cila ka qenë pjesëtare e trupit gjykues që e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale “Korrupsioni pasiv”, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së, GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar se çështjet penale nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur GJKKO-ja e Apelit edhe për pretendimin e kërkuesit se prokurorja e çështjes ka qenë në konflikt të hapur interesi, për shkak se kjo e fundit e ka hetuar e dërguar atë në gjyq padrejtësisht e në kundërshtim me ligjin. Në përfundim të arsyetimit të saj, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në bazë të neneve 277-332 të KPP-së hetimet paraprake lejohen të kryhen nga autoriteti i ngarkuar me ligj, duke garantuar të drejtën e shtetit për të ndjekur dhe ndëshkuar personin përgjegjës, kur janë marrë njoftimet e nevojshme për të vlerësuar bazueshmërinë në fakt dhe në ligj që të ushtrohet ndjekja penale. Kundër këtij vendimi në datën 20.12.2024 ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Me vendimin nr. 00-2025-594, datë 08.04.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, shkaqet e paraqitura në recurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural me rëndësi për zhvillimin apo njësimin e praktikës gjyqësore, si dhe vendimi i ankimuar nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 14.07.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.07.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë në shkelle të ligjit dhe të Kushtetutës ka vlerësuar se vendimi i GJKKO-së së Apelit është i rregullt, i bazuar në ligj e në prova, duke mos arsyetuar në mënyrë të hollësishme, ezauruese, gjithëpërfshirëse dhe analizuese për elementet e një procesi penal, çmuarjen e provave, shqyrtimin e vendimeve të dy gjykatave të faktit, sikurse rezulton të ketë vepruar në vendimin nr. 00-2023-1419, datë 14.09.2023 të të njëjtit Kolegj të Gjykatës së Lartë.

8.2. *Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi në unison të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë kanë shkelur ligjet, kodet, Kushtetutën dhe Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet e gjykimit të çështjeve të kërkuesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

9. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Neni 148, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Në rastin e veprave penale që ndiqen kryesisht nga organi i prokurorisë, pa pasur nevojën e kërkesës apo ankimit të viktimës, si rregull gjykimi kushtetues nuk vihet në lëvizje nga kallëzuesi bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, përveçse kur kallëzuesi justifikon interesin individual, të drejtpërdrejtë dhe real, pra duke treguar të drejtën substanciale që i preket nga procedimi penal (shih vendimet nr. 39, datë 17.02.2025; nr. 307, datë 17.12.2024; nr. 283, datë 25.11.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese).

12. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji konstaton se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila ka lënë të pacenuar vlerësimin e gjykatave të faktit për ligjshmërinë e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit A.B., në cilësinë e kryetarit të KLP-së dhe punonjësve të tjerë për konsumimin e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të KP-së. Duke mbajtur parasysh rrethanat e mësipërme dhe pretendimet në ankimin kushtetues, procesi penal ndaj shtetasit A.B. dhe personave të tjerë ka në objekt hetimin dhe eventualisht gjykimin e veprës penale dhe të autorëve të saj. Ndjekja penale ushtrohet nga prokuroria, e cila përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Për këtë arsye, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individit që pretendon se ka pësuar dëm nga vepra penale, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa provuar cenimin e ndonjë të drejte substanciale të lidhur drejtpërdrejt me procesin penal.

13. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuesit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

